



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2727/2 prot

Datë 08.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK me NIPT K83725201G, me adresë: Ura e Gjolës, Nr.pasurie 421/6, Zonë Kadastrale 1299, Budull, Bubq, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina 20, Tiranë

Në datën 07.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 2727/2023 protokolli, datë 07.11.2023 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2727/2023 protokoli, datë 07.11.2023.

1. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.1, për punë të ngjashme. Punët e ngjashme të paraqitura nga ky OE për furnizimin drurë dhe shkurre dekorativë nuk janë në vlerën e kërkuar në dst sa 40% e vlerës së kontratës.

Kontrata me nr. 7275/8 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Blerje pemë decorative” lidhur me bashkinë Durrës në vlerën 7,625,000 leke pa tvsh, është kontratë e ngjashme, e vlefshme, ndërkohë që kontrata me nr. 590/10 prot., datë 02.07.2021 me objekt “Mirëmbajtje e ambienteve të brendshme dhe tarracës për OSHEE Grup Sh.a dhe për Drejtorin Rajonale Tiranë OSSH Sh.a”, lidhur me Drejtorinë Rajonale Tiranë/OSSH Sh.a, nuk vlereësohet si kontratë e ngjashme për shkak se zerat e preventivit të kësaj kontrate lidhen me shërbime mirëmbajtje dhe jo me furnizim malli (bimësi).

2. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., në Shtojcën nr. 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ka deklaruar se për realizimin e kësaj kontrate prokurimi, përfshirë kërkesat për personel teknik do të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “HASTOÇI” sh.p.k. Në pikën 2.3.3 të dst është kërkuar kriteri për disponimin personelit teknik të kualifikuar – 3 autokamionistë.

a) Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik mbështetës shoqëria “HASTOÇI” sh.p.k., rezulton se për plotësimin e këtij kriteri, janë paraqitur dokumentacion vetëm për dy autokamionistë në kundërshtim me kriterin për 3 autokamionistë të kërkuar;

b) Gjithashtu, për njërin prej autokamionistëve (nga 2 të paraqitur nga shoqëria “HASTOÇI” sh.p.k.) Z. Ahmet Ceka, rezulton se kartela personale e sigurimit teknik (IQT) ka skaduar në datë 25.05.2023;

c) Nga verifikimi i dokumentacionit (dëshmitë e aftësisë profesionale) të paraqitur nga shoqëria “HASTOÇI” sh.p.k., për personelin tjetër teknik rezulton se ata kryejnë detyrat e eskavatoritistit.

3. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.3, për personel teknik të kualifikuar për punime në fidanishte. Dy nga punonjësit e paraqitur nga OE “A.M.E 2020” sh.p.k., si punonjës të kualifikuar për punime në fidanishte nuk janë pajisur me çertifikatë/diploma nga një Institucion Publik/Privat I licensuar sipas kërkesave të Ligjit nr. 15/17 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti trajnues “Certis” – me NUIS M01930006J nuk disponon liçensë të lëshuar sipas ligjit Për Arsimin dhe Formimin Profesional.

4. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.3, për personel teknik të kualifikuar për punime në fidanishte. Znj. Merita Kajmaku rezulton se kryen detyrën e Inxhinieres së Pyejeve dhe është Drejtuese Teknike me kohë të plotë pranë shoqërisë “A.M.E 2020” sh.p.k., ndërkohë që paraqitet edhe si punonjëse kopshtarë e pajisur me dëshminë përkatëse. Referuar kuadrin ligjor në fuqi drejtuesja teknike me kohë të plotë e një shoqërie nuk mund të ushtrojë dhe detyrën e një punonjësi të kualifikur po të kësaj shoqërie.

5. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.4, për paraqitjen e çertifikave zyrtare sipas kërkesave të VKM 523 datë 13.07.2016.

6. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 2.3.4 pasi ka paraqitur një kontratë furnizimi me një subjekt të huaj “Roland Skana”, por nuk ka paraqitur çertifikatat e origjinës dhe fitosanitare të këtij subjekti sipas kërkesave të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu kontrata e paraqitur është kopje e thjesht, e pa-noterizuar, e pajisur vetëm me përkthimin në gjuhën shqip dhe me vërtetimin e përkthimit.

7. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., ka paraqitur disa çertifikata fitosanitare dhe origjine të huaja të përkthyer në gjuhën shqipe por të cilat nuk janë të pajisura me vulë Apostille, sipas kërkesave të Konventës së Hagës datë 05.10.1961, në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit.

8. OE “A.M.E 2020” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar në DST pika 3.3.6 kamioncine me vinc, me mase maksimale jo me shume 3.5 ton, mjeti paraqitur kontraten qeraje me targa AB514GB me kod karrocerie (KE-Mjet per riparime e linjave elektrike) nuk ploteson kërkesat teknike te kerkuara ne dst.

Gjithashtu në ankesën e tij operatori ekonomik ankimues pretendon, citojmë: “[...] Lënien në pozitën të skualifikuar të shoqërive të tjera në këtë procedurë për arsyet e konstatuara nga AK gjatë fazës së vlerësimit dhe për shkaqet dhe arsyet e parashtruara në këtë ankesë.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 08.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri